

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.16.12.2020*

16.12.2020

Ora 17:30

**RENDI I DITËS**

*Projektvendimi “Për caktimin e njërive administrative ku do të krijohen Selitë e  
KZAZ-ve për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021”.*

**PJESËMARRJA :**

**KQZ:**

**Z.Illirjan Celibashi, Komisioner Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Stafi i KQZ: Z.Y.Merkaj, znj.E. Jorgaqi, znj.A.Tenolli, znj.M.Koja,**

**z.A.Llano**

**Përfaqësues të partive politike: PD (z.I.Kaso), LSI (z.A.Kazia)**

**Z.I.Celibashi:** Mirëmbërëma zoti Kaso! Mirëmbërëma zoti Kazia! Mirëmbërëma dhe ju anëtarë të stafit të KQZ-së! Faleminderit përfaqësuesve të partive politike për të marrë pjesë në këtë seancë publike të shqyrtimit, të diskutimit dhe miratimit të akteve të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Në fakt ora është 17:33, nuk jam shumë i sigurtë nëse do të na bashkohen dhe përfaqësues të partive të tjera politike. Ndoshta do të na duhet të presim dhe 2-3 minuta dhe pastaj mund të fillojmë. Nuk kemi asnjë konfirmim mbi pjesëmarrjen apo jo të tyre, kështu që mirë do të ishte të presim dhe pak minuta nqs jeni dakord dhe ju?!

**Z.I.Kaso, përfaqësues i Partisë Demokratike: Dakord!**

*Rifillon seanca publike e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve*

*Ora 17:36*

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Stenografia  
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.16.12.2020*

**Z.I.Celibashi:** Mendoj të fillojmë, sepse me sa duket askush tjetër nuk do t'i bashkohet kësaj seance. Ju falenderoj dhe njëherë zoti Kaso dhe zoti Kazia për pjesëmarrjen në këtë seancë publike të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për shqyrtimin e disa akteve të cilat janë në kompetencë të tij. Paraprakisht për dijeninë tuaj, por dhe të publikut e të kujtdo tjetër të interesuar dua të bëj me dije që nga sot e tutje, sot si seanca e parë e kësaj natyre e në vazhdim, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve do të shqyrtojë dhe do të diskutojë publikisht në seancë publike, të gjitha ato akte të cilat janë në kompetencën e tij për t'u miratuar sipas Kodit Zgjedhor. Mendoj se zhvillimi i kësaj procedure, pa diskutim që në rradhë të parë synon që të rrisë transparencën në procesin e administrimit dhe të përgatitjes së zgjedhjeve të ardhshme. Nga ana tjetër, unë mendoj se vjen dhe si një obligim i Komisionerit, por dhe i KQZ-së për shkak të ligjit, për ta zhvilluar veprimtarinë e tij në mënyrë transparente dhe në konsultim me të gjithë faktorët e interesuar, më së pari me partitë politike. Po kështu është justifikuar dhe interesi i publikut për të ndjekur nga afër çdo aspekt të procesit përgatitor të zgjedhjeve të ardhshme. Në seancën e sotme rendi i ditës ka katër çështje për shqyrtim.

Është projektvendimi: “Për caktimin e njësive administrative ku do të krijohen Selitë e KZAZ-ve për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021”.

Kemi pikën e dytë “Për miratimin e modelit dhe specifikimeve të dhomës së fshehtë që do të përdoren në zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021”.

Pika e tretë ka të bëjë “Për miratimin e specifikimeve të lëndës së posaçme për timbrimin e zgjedhësve për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021”.

Pika e katërt, “Për miratimin e modelit dhe specifikimeve të vulave me kod të sigurie që do të përdoren në zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021”.

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Stenografia  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.16.12.2020*

Atëherë fillojmë direkt me pikën e parë të rendit të ditës që ka të bëjë me caktimin e njësive administrative ku do të krijohen Selitë e KZAZ-ve për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021. Ky akt ka të bëjë me përcaktimin e njësive administrative ku do të vendosen selitë e KZAZ-ve. Kodi Zgjedhor në nenin 19, paragrafi 1, shkronja “n” ka përcaktuar nxjerrjen e këtij akti si kompetencë të Komisionerit Shtetëror për Zgjedhjet, pasi nuk është në kompetencë as të Komisionit Rregullator dhe as të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve. Gjithashtu Komisioni Rregullator, me vendimin nr.6, datë 30.11.2020 “Për miratimin e ngritjes së Zonave të Administrimit Zgjedhor, për zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 prill 2021”, miratoi ngritjen e nëntëdhjetë e dy Zonave të Administrimit Zgjedhor për Zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021. Selitë e KZAZ-ve përgjithësisht referohen me të njëjtat njësi administrative sikurse kanë qenë vendosur dhe në zgjedhjet e vitit 2019. Janë shtuar vetëm dy zona të reja të administrimit zgjedhor, sikurse ka vendosur Komisioni Rregullator. Në përcaktimin e njësive administrative ku do të vendosen ZAZ, ne kemi patur parasysh kriterin me shtrirjen dhe relievin gjeografik të Zonave të Administrimit Zgjedhor. Numrin dhe pozicionin gjeografik të njësive administrative të përfshira në territorin e Zonave të Administrimit Zgjedhor. Lehtësitë logjistike të transportit rrugor. Njëkohësisht kemi konsideruar siç e thashë dhe pak më lart edhe praktikën e zgjedhjeve të shkuara. Mendoj që nga pikëpamja praktike ky akt ezauron momentin e përcaktimit të njësive administrative ku do të vendosen komisionet. Në vendimmarrjet e mëpasme, Komisioneri Shtetëror në konsultim, pa diskutim dhe me përfaqësues të partive politike, do të vendosë mbi objektet konkrete ku do të caktohen selitë e ZAZ-ve dhe të VNV-ve. Ky është një hap i parë drejt kësaj

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Stenografia  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.16.12.2020*

vendimmarrje. Nuk e di nëse ju përfaqësuesit e partive politike zoti Kaso, zoti Kazia, keni ndonjë opinion në lidhje me këtë projektakt?

**Z.I.Kaso, përfaqësues i Partisë Demokratike:** Është normale që të fillojë procesi me një vendimmarrje të tillë. Është hapi i parë i një vendimmarrje të tillë, pasi pritët konfirmimi besoj nga kryetarët e bashkive për të specifikuar qendrat e KZAZ-ve që do të përbëjnë besoj në vetvehte edhe vendet ku do të administrohet procesi i numërimit të fletëve të votimit. Kështu që është një vendimmarrje që do të plotësohet më pas. Për të përshëndetur që merret në kohë dhe shpresoj që sa më shpejt të na vijne konfirmimet dhe të kemi vendndodhjen e saktë të qendrave, jo vetëm të KZAZ-ve, por dhe të VNV-ve në mënyrë që të shmangen ato problematika që mund të lidhen me vendndodhjet e vjetra në qoftë se ka të tilla. Nuk jemi në dijeni ende për shkak se midis zgjedhjeve të kaluara dhe këtyre zgjedhjeve ka qenë dhe një fatkeqësi natyrore i referohem tërmetit i cili mund të ketë dëmtuar. Mund të ketë bërë të papërdorshme, ndoshta një pjesë të vendeve të vjetra të numërimit të votave. Në këtë prizëm sa më shpejt të kemi konfirmimet nga njësitë e qeverisjes vendore, aq më shpejt Komisioneri mund të procedojë me përcaktimin ekzakt të vendndodhjeve dhe aq më shpejt mund të merren dhe masat logjistike për sa i përket dhe instalimit të teknologjisë që do të jetë e nevojshme dhe hapat e tjerë logjistikë. Në këtë këndvështrim përshëndetet vendimmarrja dhe shpresoj të ecet sa më shpejt në plotësimin e plotë të saj, faleminderit!

**Z.I.Celibashi:** Faleminderit! Zoti Kazia?!

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Stenografia  
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.16.12.2020*

**Z.A.Kazia, përfaqësues i Lëvizja Socialiste për Integrim:** Edhe unë i bashkohem zotit Kaso, për sa i përket pjesës së vendimmarrjes për këtë akt të sotëm që do të pasohet nga akte të tjera siç e thatë dhe ju. Ju përgëzoj për pjesën e transparencës në ftesën që i bëni publike subjekteve politike të përfaqësuara nga ne në këtë rast dhe të vazhdojmë ecurinë siç e kemi nisur, sepse është një hap i mirë dhe në kuadër të një transparence, të një qëndrimi ndryshe, një qasje ndryshe drejt zgjedhjeve të lira dhe të ndershme.

**Z.I.Celibashi:** Po faleminderit! Atëherë, meqenëse prej jush nuk ka asnjë rekomandim, ose opinion tjetër veç atij që është propozuar nga Komisioneri e miratoj këtë akt duke vendosur që për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021, Selitë e KZAZ-ve do të krijohen në njësitë administrative, si vijon dhe për dijeni dhe të publikut edhe tuajën, por dhe për rekord të aktit, unë po e lexoj, besoj se do të keni durimin. Atëherë,

Qarku Shkodër:

KZAZ nr. 1, Bashkia Malësi e Madhe do të vendoset në Koplík.

KZAZ nr. 2, Bashkia Shkodër do të vendoset në Shkodër.

KZAZ nr. 3, Bashkia Shkodër do të vendoset në Shkodër.

KZAZ nr. 4, Bashkia Shkodër do të vendoset në Shkodër.

KZAZ nr. 5, Bashkia Shkodër do të vendoset në Shkodër.

KZAZ nr. 6, Bashkia Vau Dejës do të vendoset në Bushat.

KZAZ nr. 7, Bashkia Pukë do të vendoset në Pukë.

KZAZ nr. 8, Bashkia Fushë-Arrëz do të vendoset në Fushë-Arrëz.

Qarku Kukës:

KZAZ nr. 9, Bashkia Tropojë do të vendoset në qytetin Bajram Curri.

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Stenografia  
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.16.12.2020*

KZAZ nr. 10, Bashkia Has do të vendoset në Krumë.

KZAZ nr.11, Bashkia Kukës do të vendoset në qytetin e Kukësit.

Qarku Lezhë:

KZAZ nr.12, Bashkia Lezhë do të vendoset në Qytetin e Lezhës.

KZAZ nr.13, Bashkia Lezhë do të vendoset në Qytetin e Lezhës.

KZAZ nr.14, Bashkia Mirditë do të vendoset në Qytetin e Rrëshenit.

KZAZ nr.15, Bashkia Kurbin do të vendoset në Laç.

Qarku Dibër:

KZAZ nr.16, Bashkia Mat do të vendoset në Qytetin e Burrelit.

KZAZ nr.17, Bashkia Klos do të vendoset në Klos.

KZAZ nr.18, Bashkia Bulqizë do të vendoset në Qytetin e Bulqizës.

KZAZ nr.19, Bashkia Dibër do të vendoset në Qytetin e Peshkopisë.

Qarku Durrës:

KZAZ nr.20, Bashkia Krujë do të vendoset në Qytetin e Krujës.

KZAZ nr.21, Bashkia Durrës do të vendoset në Sukth.

KZAZ nr.22, Bashkia Durrës do të vendoset në Qytetin e Durrësit.

KZAZ nr.23, Bashkia Durrës do të vendoset në Qytetin e Durrësit.

KZAZ nr.24, Bashkia Durrës do të vendoset në Qytetin e Durrësit.

KZAZ nr.25, Bashkia Shijak do të vendoset në Qytetin e Shijak.

Qarku Tiranë:

KZAZ nr.26, Bashkia Vorë do të vendoset në Qytetin e Vorës.


KZAZ nr.27, Bashkia Kamëz do të vendoset në Kamëz.

KZAZ nr.28, Bashkia Kamëz do të vendoset në Paskuqanë.

KZAZ nr.29, Bashkia Tiranë do të vendoset në Qytetin e Tiranës.

KZAZ nr.30, Bashkia Tiranë do të vendoset në Qytetin e Tiranës.

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Stenografia  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.16.12.2020*


KZAZ nr.31, Bashkia Tiranë do të vendoset në Nj.Administrative nr.1.  
KZAZ nr.32, Bashkia Tiranë do të vendoset në Nj.Administrative nr.2.  
KZAZ nr.33, Bashkia Tiranë do të vendoset në Nj.Administrative nr.3.  
KZAZ nr.34, Bashkia Tiranë do të vendoset në Nj.Administrative nr.4.  
KZAZ nr.35, Bashkia Tiranë do të vendoset në Nj.Administrative nr.5.  
KZAZ nr.36, Bashkia Tiranë do të vendoset në Nj.Administrative nr.6.  
KZAZ nr.37, Bashkia Tiranë do të vendoset në Nj.Administrative nr.7.  
KZAZ nr.38, Bashkia Tiranë do të vendoset në Nj.Administrative nr.8.  
KZAZ nr.39, Bashkia Tiranë do të vendoset në Nj.Administrative nr.9.  
KZAZ nr.40, Bashkia Tiranë do të vendoset në Nj.Administrative nr.10.  
KZAZ nr.41, Bashkia Tiranë do të vendoset në Nj.Administrative nr.11.  
KZAZ nr.42, Bashkia Kavajë do të vendoset në Qytetin e Kavajës.  
KZAZ nr.43, Bashkia Rrogozhinë do të vendoset në Rrogozhinë.

Qarku Elbasan:

KZAZ nr.44, Bashkia Peqin do të vendoset në Peqin.  
KZAZ nr.45, Bashkia Belsh do të vendoset në Belsh.  
KZAZ nr.46, Bashkia Cërrik do të vendoset në Qytetin e Cërrikut.  
KZAZ nr.47, Bashkia Elbasan do të vendoset në Qytetin e Elbasanit.  
KZAZ nr.48, Bashkia Elbasan do të vendoset në Qytetin e Elbasanit.  
KZAZ nr.49, Bashkia Elbasan do të vendoset në Qytetin e Elbasanit.  
KZAZ nr.50, Bashkia Elbasan do të vendoset në Qytetin e Elbasanit.  
KZAZ nr.51, Bashkia Gramsh do të vendoset në Qytetin e Gramshit.  
KZAZ nr.52, Bashkia Librazhd do të vendoset në Qytetin e Librazhdit.  
KZAZ nr.53, Bashkia Prrenjas do të vendoset në Qytetin e Prrenjasit.

Qarku Fier:

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Stenografia  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.16.12.2020*

KZAZ nr.54, Bashkia Lushnjë do të vendoset në Qytetin e Lushnjës.

KZAZ nr.55, Bashkia Lushnjë do të vendoset në Qytetin e Lushnjës.

KZAZ nr.56, Bashkia Divjakë do të vendoset në Divjakë.

KZAZ nr.57, Bashkia Fier do të vendoset në Levan.

KZAZ nr.58, Bashkia Fier do të vendoset në Mbrostar.

KZAZ nr.59, Bashkia Fier do të vendoset në Qytetin e Fierit.

KZAZ nr.60, Bashkia Patos do të vendoset në Patos.

KZAZ nr.61, Bashkia Roskovec do të vendoset në Roskovec.

KZAZ nr.62, Bashkia Mallakastër do të vendoset në Qytetin e Ballshit.

Qarku Berat:

KZAZ nr.63, Bashkia Ura-Vajgurore do të vendoset në Dimal.

KZAZ nr.64, Bashkia Kuçovë do të vendoset në Qytetin e Kuçovës.

KZAZ nr.65, Bashkia Berat do të vendoset në Qytetin e Beratit.

KZAZ nr.66, Bashkia Berat do të vendoset në Otlak.

KZAZ nr.67, Bashkia Poliçan do të vendoset në Qytetin e Poliçanit.

KZAZ nr.68, Bashkia Skrapar do të vendoset në Qytetin e Çorovodës.

Qarku Korçë:

KZAZ nr.69, Bashkia Pogradec do të vendoset në Qytetin e Pogradecit.

KZAZ nr.70, Bashkia Maliq do të vendoset në Maliq.

KZAZ nr.71, Bashkia Pustec do të vendoset në Pustec.

KZAZ nr.72, Bashkia Devoll do të vendoset në Bilisht.

KZAZ nr.73, Bashkia Korçë do të vendoset në Qytetin e Korçës.

KZAZ nr.74, Bashkia Korçë do të vendoset në Qytetin e Korçës.

KZAZ nr.75, Bashkia Kolonjë do të vendoset në Qytetin e Ersekës.

Qarku Gjirokastrë:

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Stenografia  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.16.12.2020*

KZAZ nr.76, Bashkia Përmet do të vendoset në Qytetin e Përmetit.

KZAZ nr.77, Bashkia Këlcyrë do të vendoset në Këlcyrë.

KZAZ nr.78, Bashkia Memaliaj do të vendoset në Qytetin e Memaliajt.

KZAZ nr.79, Bashkia Tepelenë do të vendoset në Qytetin e Tepelenës.

KZAZ nr.80, Bashkia Gjirokastrër do të vendoset në Qytetin e Gjirokastrës.

KZAZ nr.81, Bashkia Libohovë do të vendoset në Libohovë.

KZAZ nr.82, Bashkia Dropull do të vendoset në Jorgucat.

Qarku Vlorë:

KZAZ nr.83, Bashkia Vlorë do të vendoset në Qytetin e Vlorës.

KZAZ nr.84, Bashkia Vlorë do të vendoset në Qytetin e Vlorës.

KZAZ nr.85, Bashkia Vlorë do të vendoset në Qytetin e Vlorës.

KZAZ nr.86, Bashkia Vlorë do të vendoset në Qytetin e Vlorës.

KZAZ nr.87, Bashkia Selenicë do të vendoset në Kotë.

KZAZ nr.88, Bashkia Himarë do të vendoset në Himarë.

KZAZ nr.89, Bashkia Delvinë do të vendoset në Delvinë.

KZAZ nr.90, Bashkia Sarandë do të vendoset në Qytetin e Sarandës.

KZAZ nr.91, Bashkia Finiq do të vendoset në Dërmish.

KZAZ nr.92, Bashkia Konispol do të vendoset në Konispol.

Kjo ishte për sa i përket kësaj pike të rendit të ditës, shkoi pak gjatë, por mendoj se ishte e domosdoshme.

**Vendimi nr.32**

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Stenografia  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.16.12.2020*

16.12.2020

Ora 17:55

**RENDI I DITËS**

*Projektvendimi “Për miratimin e modelit dhe specifikimeve të dhomës së fshehtë që do të përdoren në zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021”.*

**PJESËMARRJA :**

**KQZ:**

**Z.Illirjan Celibashi, Komisioner Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Stafi i KQZ: Z.Y.Merkaj, znj.E. Jorgaqi, znj.A.Tenolli, znj.M.Koja,  
z.A.Llano**

**Përfaqësues të partive politike: PD (z.I.Kaso), LSI (z.A.Kazia)**

**Z.I.Celibashi:** Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës që ka të bëjë “Për miratimin e modelit dhe specifikimeve të dhomës së fshehtë që do të përdoren në zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021”. Edhe ky akt është një akt që Kodi Zgjedhor e përcakton si kompetencë të Komisionerit Shtetëror për Zgjedhjet. Është një akt që vjen në bazë të nenit neni 99, paragrafi 2, shkronja “c”, neni 100, paragrafi 1, shkronja “ç”, neni 101, paragrafit 1, shkronja “a”. Është një ndër aspektet më të rëndësishme të procesit përgatitor dhe logjistik të zgjedhjeve, pasi ka të bëjë me një komponent shumë të rëndësishëm të procesit zgjedhor, sikurse është siguria e fshehtësisë së votimit. Koncept ky i cili gjendet i sanksionuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, por edhe në akte të ndryshme ndërkombëtare edhe pse në pamje të parë duket si një akt i thjeshtë që ka të bëjë me një element teknik, por është një akt shumë i rëndësishëm për standartin e procesit zgjedhor. Përgjithësisht modeli i dhomës së fshehtë është përdorur dhe në

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Stenografia  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.16.12.2020*

zgjedhjet e kaluara. Për lehtësi të transportit dhe menaxhimit të tij si element, dhoma e fshehtë është përsëri e prodhuar prej kartoni, por që siguron të gjitha ato karakteristika teknike për lehtësi të përdorimit, kur vjen puna, nga zgjedhësit. Ju keni bashkëngjitur aktit dhe një model. Në se keni ndonjë mendim në lidhje me këtë pikë të rendit të ditës, jeni të lutur të na e prezantoni. Po zoti Kaso!

**Z.I.Kaso, përfaqësues i Partisë Demokratike:** Faleminderit Kryetar, besoj se nuk ka pas ndonjë problem shqetësues në lidhje me modelet e dhomave të fshehta të përdorura dhe në zgjedhjet e kaluara. I kanë plotësuar parametrat dhe për më tepër besoj që një pjesë të mirë të tyre KQZ-ja, përveç atyre që mund të jenë dëmtuar nga proceset zgjedhore të mëparshme, por besoj se pjesa më e madhe është gjendje. Nuk shohim ndonjë arsye të mos përdoren për aq sa është e mundur.


**Z.I.Celibashi:** Faleminderit! Zoti Kazia?!

**Z.A.Kazia, përfaqësues i Lëvizja Socialiste për Integrim:** Unë jam dakord me Lidhjen nr.1 bashkëlidhur këtij vendimi, për sa i përket specifikimeve të dhomave të fshehta. Nuk kam ndonjë kundërshtim, apo sugjerim.

**Z.I.Celibashi:** Faleminderit! Meqenëse nuk kemi propozime për ndryshime të projektaktit, atëherë projektaktin po e miratoj ashtu sikurse është në projektin dhe draftin e vet. Meqenëse si element ka të bëjë me dukjen, pamjen fizike besoj se konsultimi me faqen e internetit të KQZ-së do të shuajë dhe interesin, apo qoftë dhe kuriozitetin e të gjithëve në lidhje me atë se si është dhoma e fshehtë për këto zgjedhje, faleminderit.

**Vendimi nr.33**

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Stenografia  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.16.12.2020*

16.12.2020

Ora 17:55

**RENDI I DITËS**

*Projektvendimi “Për miratimin e modelit dhe specifikimeve të dhomës së fshehtë që do të përdoren në zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021”.*

**PJESËMARRJA :**

**KQZ:**

**Z.Illirjan Celibashi, Komisioner Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Stafi i KQZ: Z.Y.Merkaj, znj.E. Jorgaqi, znj.A.Tenolli, znj.M.Koja,  
z.A.Llano**

**Përfaqësues të partive politike: PD (z.I.Kaso), LSI (z.A.Kazia)**

**Z.I.Celibashi:** Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës që ka të bëjë “Për miratimin e modelit dhe specifikimeve të dhomës së fshehtë që do të përdoren në zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021”. Edhe ky akt është një akt që Kodi Zgjedhor e përcakton si kompetencë të Komisionerit Shtetëror për Zgjedhjet. Është një akt që vjen në bazë të nenit neni 99, paragrafi 2, shkronja “c”, neni 100, paragrafi 1, shkronja “ç”, neni 101, paragrafit 1, shkronja “a”. Është një ndër aspektet më të rëndësishme të procesit përgatitor dhe logjistik të zgjedhjeve, pasi ka të bëjë me një komponent shumë të rëndësishëm të procesit zgjedhor, sikurse është siguria e fshehtësisë së votimit. Koncept ky i cili gjendet i sanksionuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, por edhe në akte të ndryshme ndërkombëtare edhe pse në pamje të parë duket si një akt i thjeshtë që ka të bëjë me një element teknik, por është një akt shumë i rëndësishëm për standartin e procesit zgjedhor. Përgjithësisht modeli i dhomës së fshehtë është përdorur dhe në

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Stenografia  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.16.12.2020*

zgjedhjet e kaluara. Për lehtësi të transportit dhe menaxhimit të tij si element, dhoma e fshehtë është përsëri e prodhuar prej kartoni, por që siguron të gjitha ato karakteristika teknike për lehtësi të përdorimit, kur vjen puna, nga zgjedhësit. Ju keni bashkëngjitur aktit dhe një model. Në se keni ndonjë mendim në lidhje me këtë pikë të rendit të ditës, jeni të lutur të na e prezantoni. Po zoti Kaso!

**Z.I.Kaso, përfaqësues i Partisë Demokratike:** Faleminderit Kryetar, besoj se nuk ka pas ndonjë problem shqetësues në lidhje me modelet e dhomave të fshehta të përdorura dhe në zgjedhjet e kaluara. I kanë plotësuar parametrat dhe për më tepër besoj që një pjesë të mirë të tyre KQZ-ja, përveç atyre që mund të jenë dëmtuar nga proceset zgjedhore të mëparshme, por besoj se pjesa më e madhe është gjendje. Nuk shohim ndonjë arsye të mos përdoren për aq sa është e mundur.


**Z.I.Celibashi:** Faleminderit! Zoti Kazia?!

**Z.A.Kazia, përfaqësues i Lëvizja Socialiste për Integrim:** Unë jam dakord me Lidhjen nr.1 bashkëlidhur këtij vendimi, për sa i përket specifikimeve të dhomave të fshehta. Nuk kam ndonjë kundërshtim, apo sugjerim.

**Z.I.Celibashi:** Faleminderit! Meqenëse nuk kemi propozime për ndryshime të projektaktit, atëherë projektaktin po e miratoj ashtu sikurse është në projektin dhe draftin e vet. Meqenëse si element ka të bëjë me dukjen, pamjen fizike besoj se konsultimi me faqen e internetit të KQZ-së do të shuajë dhe interesin, apo qoftë dhe kuriozitetin e të gjithëve në lidhje me atë se si është dhoma e fshehtë për këto zgjedhje, faleminderit.

**Vendimi nr.33**

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Stenografia  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.16.12.2020*

16.12.2020

Ora 17:58

**RENDI I DITËS**

Projektvendimi “Për miratimin e specifikimeve të lëndës së posaçme për timbrimin e zgjedhësve për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021”.

**PJESËMARRJA :**

**KQZ:**

**Z.Illirjan Celibashi, Komisioner Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Stafi i KQZ: Z.Y.Merkaj, znj.E. Jorgaqi, znj.A.Tenolli, znj.M.Koja,**

**z.A.Llano**

**Përfaqësues të partive politike: PD (z.I.Kaso), LSI (z.A.Kazia)**

**Z.I.Celibashi:** Kalojmë tek pika e tretë që ka të bëjë “Për miratimin e specifikimeve të lëndës së posaçme për timbrimin e zgjedhësve për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021”. Edhe ky akt është në kompetencën e Komisionerit Shtetëror për Zgjedhjet. Është një akt i cili vjen në bazë dhe në zbatim të neni 105 paragrafi 1 shkronja “dh” të Kodit Zgjedhor. Edhe ky element teknik i procesit zgjedhor ka një rëndësi mjaft të veçantë, pasi lidhet me sigurinë dhe integritetin e këtij procesi. Mendoj që kemi reflektuar edhe ato eksperiencat si për mirë po ashtu dhe ato negative në lidhje me përdorimin e bojës së veçantë timbruese për zgjedhësit. Kemi menduar që specifikime të tilla si ajo që ka të bëjë me dukshmërinë e saj me shikim të lirë. Siguria që të mos hiqet për jo më pak se 24 orë nga koha e timbrimit, me efekt të menjëhershëm, ngjyrë e zezë, përmbajtje nitrat argjendi 20%, apo elementë të tjerë kimikë të padëmshëm për organizmin e votuesit, e pa cënueshme nga agjentë atmosferikë. Mendoj se nga pikëpamja

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Stenografia  
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.16.12.2020*


teknike janë karakteristika që sigurojnë integritetin e këtij komponenti. Nuk e di nëse ju përfaqësuesit e partive politike zoti Kaso, zoti Kazia, keni ndonjë opinion në lidhje me këtë aspekt, me këtë çështje?

**Z.I.Kaso, përfaqësues i Partisë Demokratike:** Jo zoti Kryetar, pavarësisht se për këto zgjedhje do të futet për herë të parë, duke shpresuar që gjithshka të shkojë mirë, edhe risia e kodit që ka të bëjë me identifikimin biometrik të zgjedhësve që do të ofrojë një garanci më shumë në drejtim të aspektit të ushtrimit të të drejtës së votës nga ai që e ka këtë të drejtë dhe jo nga persona të tjerë në emër të tij. Nuk ka asnjë arsye, kështu ka menduar ligjvënësi, por ndajmë të njejtin mendim dhe ne që s'ka pse të heqim dorë nga ato garanci të procesit që deri më sot janë treguar të vlefshme. Njëri prej të cilave, nga më të rëndësishmit është dhe procesi i timbrimit të gishtit të personit që voton. Vlerësojmë që akti risjell të njejtat standarte dhe specifikime teknike dhe garanci të cilat i ka pas ky proces dhe më parë përse i takon këtij elementi të rëndësishëm. Në këtë aspekt jemi dakord me aktin.

**Z.I.Celibashi:** Faleminderit! Zoti Kazia?!

**Z.A.Kazia, përfaqësues i Lëvizja Socialiste për Integrim:** Edhe ne jemi dakord me aktin. Pjesa e aktit është një pjesë specifike që ka të bëjë me lëndën e posaçme për timbrimin e zgjedhësve. Për sa i takon pjesës që specifikuat dhe ju germave që mbështetet ky akt, specifikimet teknike të lëndës janë shterruese dhe nuk kemi asnjë lloj kundërshtimi.

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Stenografia  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.16.12.2020*

**Z.I.Celibashi:** Ju faleminderit, atëhere meqenëse nuk kemi ndonjë propozim për shtesa e ndryshime të këtij akti e miratoj këtë projektakt sipas tekstit vijues. Miratoj specifikimet e lëndës së posaçme për timbrimin e zgjedhësve, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021, me karakteristikat si më poshtë:

- a) Të jetë e dukshme me shikim të lirë;
- b) Të mos hiqet për jo më pak se 24 orë nga koha e timbrimit;
- c) Të jetë me efekt të menjëhershëm;
- ç) Të jetë në ngjyrë e zezë;
- d) Të ketë përmbajtje nitrat argjendi 20%;
- dh) Të jetë e padëmshme për shëndetin;
- e) Të jetë e pa cënueshme nga agjentë atmosferikë. Ky ishte dhe projektakti që ka të bëjë me pikën e tretë të rendit të ditës.

**Vendimi nr.34**

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Stenografia  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.16.12.2020*

16.12.2020

Ora 18:02

**RENDI I DITËS**

**Projektvendimi “Për miratimin e modelit dhe specifikimeve të vulave me kod sigurie që do të përdoren në zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021”.**

**PJESËMARRJA :**

**KQZ:**

**Z.Ilirjan Celibashi, Komisioner Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Stafi i KQZ: Z.Y.Merkaj, znj.E. Jorgaqi, znj.A.Tenolli, znj.M.Koja,**

**z.A.Llano**

**Përfaqësues të partive politike: PD (z.I.Kaso), LSI (z.A.Kazia)**

**Z.I.Celibashi:** Vazhdojmë me pikën e katërt të rendit të ditës që ka të bëjë me “Miratimin e modelit dhe specifikimeve të vulave me kod sigurie që do të përdoren në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021”. Edhe ky akt është në kompetencën e Komisionerit Shtetëror për Zgjedhjet. Edhe në lidhje me këtë akt duhet të evidentoj se edhe në këtë rast KQZ është mbështetur në eksperiencën e zgjedhjeve të shkuara. Pra, nuk ka pas vend mendojmë ne për të bërë ndryshime thelbësore në lidhje me karakteristikat teknike që do të kenë këto vula. Mendojmë që ai model vulash që përgjithësisht është përdorur në zgjedhjet e shkuara do të përdoret dhe për këto zgjedhje, duke siguruar qëndrueshmërinë e tyre si elementë teknikë dhe sigurinë. Mendoj se lidhur me këtë çështje të paktën në dijeninë time nuk janë konstatuar probleme në lidhje me tipin dhe modelin që është përdorur. Kështu që është menduar që pak a shumë të jenë të njejtat modele që do të përdoren dhe në këto zgjedhje. Nuk e di nëse keni ndonjë mendim tjetër?

**Zbardhi materialin e inçizuar  
Stenografia  
Merita DULAKU**

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.16.12.2020*

**Z.I.Kaso, përfaqësues i Partisë Demokratike:** Jo zoti Kryetar edhe ky element për sa i përket kodeve dhe vulave të sigurisë që do të mbyllet kutia e fletëve të votimit dhe kutia e materialeve zgjedhore, janë demonstruar në zgjedhjet e mëparëshme si elementë të vlefshëm që nuk kanë dhënë problematika të veçanta, kështu që mbështesim ripërdorimin e tyre dhe në këto zgjedhje.

**Z.I.Celibashi:** Faleminderit! Zoti Kazia?!

**Z.A.Kazia, përfaqësues i Lëvizja Socialiste për Integrim:** Edhe unë jam dakord me specifikimet e elementëve përbërës për vulat me kod sigurie. Nuk ka pasë tregues negativ në to, kështu që të vijojnë.

**Z.I.Celibashi:** Ju faleminderit, edhe këtë projektakt e miratoj sipas tekstit që kam propozuar. Duke qenë se këto karakteristika të kodeve dhe vulave të sigurisë është e vështirë të përshkruhen me fjalë, për këdo të interesuar, apo kurioz do ta gjejë përshkrimin dhe specifikimet teknike të tyre të pasqyruara ashtu siç i ka akti në vendimin që sapo miratova, i cili mund të konsultohet në faqen e internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Këto ishin çështjet që kishim për shqyrtim në seancë publike nga ana e Komisionerit Shtetëror për Zgjedhjet, dua t'u falenderoj zoti Kaso dhe zoti Kazia për kontributin tuaj dhe ju uroj një mbrëmje të këndshme, natën e mirë dhe faleminderit!

**Vendimi nr.35**

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Stenografia  
Merita DULAKU*